



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 352, datë 09.09.2021

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TIRANË PËR TRE POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 184 DHE NR. 185, DATË 28.05.2020 DHE NR. 396, DATË 07.10.2020 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Alban Toro,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 184, nr. 185, datë 28.05.2020 dhe nr. 396, datë 07.10.2020.
2. Vendimi nr. 284, datë 08.09.2020 dhe nr. 570, datë 20.11.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR